



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

---



**RAPORT  
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E HETIMIT DHE ZBULIMIT TË  
KRIMIT, SI DHE ADMINISTRIMIT TË RASTEVE**

**Nr. 6/2019**

**Prishtinë, 31 dhjetor 2019**

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve
<b>Data e përgatitjes</b>	31 dhjetor 2019
<b>Përgatitur nga</b>	Fitore Gajraku, udhëheqëse e ekipit të inspektimit, Xhavit Fetahaj, inspektor
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Miradije Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	31 dhjetor 2019

### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2. Qëllimi.....(6-6)
- 2.3. Objekti.....(6-6)
- 2.4. Subjekti.....(6-6)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(6-7)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(7-7)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(7-7)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(7-7)
- 2.10. Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(8-8)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(8-8)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Përformanca e njësive hetimore në hetimin dhe zbulimin e krimit.....(9-14)
- 3.2. Menaxhimi i dëshmive dhe sendeve të konfiskuara..... (14-23)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(24-26)

Shtojcat

## **1. Përmbledhja ekzekutive**

---

### **1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit**

1.1.1. Zbulimi i veprave penale është proces që fillon nga e paqarta dhe informacioni jo i plotë mbi veprën penale dhe autorin e saj, si dhe vazhdon përmes kërkimit, mbledhjes, vlerësimit dhe verifikimit të dëshmimeve e fakteve, deri në fazën finale ku bazohet vendimi për ngritjen e akuzës apo ndërprerjen e hetimit. Prokuroria kompetente mbikëqyrë respektimin e ligjshmërisë gjatë realizimit të hetimeve, kurse puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit. Bazuar në këtë, Policia e Kosovës ndërmer veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbulojë veprat penale dhe kryerësit e tyre. IPK me këtë inspektim ka vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave nga Sektorët Rajonalë të Hetimeve, gjatë menaxhimit të rasteve penale, dhe rregullësinë e lëndëve me dokumentet dhe formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin, zbulimin dhe dokumentimin e krimit.

1.1.2. Nga inspektimi i dosjeve penale ka rezultuar se një numër i tyre nuk kanë pasur Raportin policor njoftues për Prokurorin e Shtetit. Janë identifikuar një mori lëndësh, në të cilat nuk është respektuar zinxhiri komandues për t'iu nënshtruar kontrollit dhe nënshkrimit nga mbikëqyrësit. Formularët e përdorur brenda dosjeve penale nuk janë unik në kuadër të sektorëve dhe nuk ka një standard të aplikuar të hartimit të shkresave të lëndëve. Në disa dosje janë gjetur procesverbale (deklarata) që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të palëve. Në disa deklarata që i përmbajnë të drejtat e rezervuara, nuk janë konform Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK). Ka deklarata të panënshkruara nga marrësit e deklaratave, të dyshuarit apo dëshmitarët e intervistuar. Kallëzimet e ngritura penale plotësojnë kriteret bazike dhe përmbajnë elemente të nevojshme përmbajtësore për t'u dorëzuar në Prokuroritë kompetente. IPK-ja çmon angazhimet policore në respektimin e dispozitave ligjore të KPPK-së mbi përfaqësimin e avokatit në rastet kur prania e tij ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës së të dyshuarit.

1.1.3. Matja e efikasitetit dhe performances së njësive hetimore rajonale është sfiduar për shkak të mungesës së të dhënave statistikore mbi lëndët e bartura penale nga vitet e kaluara. Raportet vjetore të drejtorive rajonale policore nuk pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të këtyre lëndëve penale, andaj IPK-ja ka matur performancën dhe efikasitetin vetëm për lëndët e inicuar gjatë viteve të fundit. Ky problem shtron nevojën për rishikim të politikave aktuale mbi pasqyrimin më të plotë të të dhënave mbi krimin dhe statusin e rasteve që për arsye të ndryshme vazhdojnë të mbeten pa epilog. Numri i veprave penale në kompetencë të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve ka rënë në vitin 2018, krahasuar me një vit më parë, kurse hetuesit rajonal të Prishtinës kanë pasur ngarkesën më të madhe me raste krahasuar me hetuesit e sektorëve tjerë rajonalë. Trendi i zbulueshmërisë ka shënuar ngritje gjatë vitit 2018 prej 3% krahasuar me një vit më parë. Marrë parasysh dy vite krahasimore, del se Ferizaj (2017) dhe Gjakova (2018) kanë realizuar shkallën më të lartë të zbulueshmërisë, derisa Prizreni (2017) dhe Prishtina (2018) kanë realizuar shkallë më të ulët të zbulueshmërisë. Përgjithësisht në vitin 2017 rezulton një raport 1 me 2 i numrit të rasteve të pazbuluara karshi atyre të zbuluara, derisa në vitin 2018, ky raport sillet në 1 me 3 në favor të numrit të rasteve të zbuluara. Gjatë vitit 2017 tek Ferizaj, raporti rezulton të jetë 1 me 7 në favor të numrit të rasteve të zbuluara, derisa tek Prizreni është 1 me 0.4 në favor të numrit të rasteve të pazbuluara. Gjatë vitit 2018, tek Gjakova ky raport rezulton të jetë 1 me 14, derisa tek Prishtina dhe Gjilani rezulton të jetë 1 me 2 në favor të rasteve të zbuluara.

1.1.4. Dëshmitë janë të ndërlidhura me hetimin e veprave penale dhe ato duhet ruajtur deri sa të përfundojë procedura hetimore dhe penale. Fusha e trajtimit të dëshmimeve është e rregulluar me procedurë për vendosjen, trajtimin dhe ruajtjen e tyre. Procedurat në fuqi ofrojnë rregulla të qarta për parandalimin e humbjes, dëmtimit, shkatërrimit, kalbjes apo kontaminimit të dëshmimeve. Disa nga Dhomat e dëshmimeve në kuadër të drejtorive rajonale nuk kanë përmbushur disa nga kriteret e përcaktuara për trajtimin e duhur të dëshmimeve. Në disa raste, për shkak të specifikave të tyre, shihet se dëshmitë nuk ruhen të ndara në vende të posaçme. Janë evidentuar raste ku paratë nuk ruhen brenda zonës së deponimit, si dhe raste kur mostrat biologjike nuk ruhen në frigorifer. Në të shumtën e rasteve, dëshmitë janë identifikuar lehtë, por jo në të gjitha rastet ato kanë qenë të paketuara dhe të shënuara në mënyrën e duhur. Vërehet në disa raste mungesë e të dhënave mbi lëvizjet e dëshmimeve në zinxhirët e ruajtjes dhe regjistra. Duhet përmirësuar gjendja në mbajtjen e evidencave më të plota të dëshmimeve. Duhet ngritur vëmendja që në rastet e hapjes së dëshmimeve, të respektohet procedura e regjistrimit. Duhet ndërmarrë masa për ngritjen e sigurisë së dëshmimeve, duke shfrytëzuar zona të përshtatshme brenda hapësirave të deponimit për vendosjen e llojeve të caktuara të dëshmimeve. Duhet kushtuar kujdes rregullit mbi të drejtën e personave të autorizuar që të mbajnë çelësat e Dhomave të dëshmimeve për të pamundësuar qasjet e paautorizuara.

1.1.5. Niveli i sigurisë në Dhomat e dëshmimeve në kuadër të drejtorive rajonale vlerësohet se duhet avansuar dhe kjo nisët nga fakti se sistemet e alarmit, video mbikëqyrjes dhe detektimit të tymit ndryshojnë sipas dhomave. Ka Dhoma të dëshmimeve që kanë sisteme të tilla funksionale, disa nga to edhe pse i kanë të instaluar, ato nuk janë funksionale, por ka edhe prej tyre që fare nuk i kanë sistemet e tilla. Disa nga Dhomat që kanë probleme me lagështinë, janë vendosur në hapësira të papërshtatshme. Në Gjilan, dëshmitë ruhen në kushte të papërshtatshme, përshkak të nivelit të lartë të lagështisë. Dëshmitë janë të rrezikuara nga dëmtimi, prishja dhe kontaminimi. Mospërdorimi i frigoriferëve dhe mungesa e frigoriferëve adekuat ka bërë që në disa Dhoma të dëshmimeve, dëshmitë të ruhen në vende joadekuate, gjë që duhet evituar. Në shumicën e Dhomave të dëshmimeve nuk janë kryer revizione, inventarizime dhe inspektime, kurse në disa prej tyre ato nuk janë realizuar në baza të rregullta periodike.

## **1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga 12 rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar (inspektimi nr. 5/2013), dy (2) prej rekomandimeve janë përmbushur plotësisht, tre (3) prej tyre janë përmbushur përgjithësisht (në masë të madhe), katër (4) prej tyre janë përmbushur pjesërisht dhe tre (3) rekomandime nuk janë vlerësuar (*për më tepër referoju tabelës në shtojcën 1*).

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së (2019) ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit se Policia është e përkushtuar që të parandalojë, hetojë dhe zbulojë krimet dhe të reduktojë nivelin e kriminalitetit, siç parashihet në planet strategjike, në drejtim të forcimit të sundimit të rendit dhe ligjit. Andaj, është e nevojshme që profesionalizmi, përkushtimi dhe llogaridhënia policore të jenë evidente dhe të qëndrueshme në menaxhimin sa më efektiv të rasteve penale. Duke konsideruar se inspektimi paraqet instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e këtyre fushave, Kryeshefi Ekzekutiv me datën 10 korrik 2019, mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Poashtu, do të vlerësohet edhe përmbushja e rekomandimeve të lëna nga inspektimi i kaluar në këtë fushë të menaxhimit.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me menaxhimin e rasteve penale;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse
- Që të identifikojë mangësitë-dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionim më të mirë.

### **2.3. Objekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të rregullt është vlerësuar kryerja e detyrave në fushën e menaxhimit të hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve.

### **2.4. Subjekti i inspektimit**

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në nivel lokal, kryesisht në Sektorët Rajonal të Hetimeve të Drejtorive Rajonale Policore.

### **2.5. Objektivat e inspektimit**

2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i kapaciteteve operacionale në luftimin e krimit;
- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave në hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Vlerësimi i përmbushjes së objektivave të strategjive policore për luftimin e krimit;
- Analizimi-krahasimi i indikatorëve të krimit dhe performances në luftimin e krimit;
- Vlerësimi i respektimit të procedurave dhe rregullave në menaxhimin e dëshmive;
- Vlerësimi i mënyrës së administrimit të dosjeve penale;
- Vlerësimi i përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimet e kaluara.

## **2.6. Rëndësia e inspektimit**

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e profesionalizmit dhe përkushtimit të personelit për të siguruar shkallë më të lartë të efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e veprave penale;
- Ngritjen e përgjegjësisë në respektimin e rregullave-procedurave për hetimin e krimit;
- Ngritjen e vetëdijes për të zhvilluar qasje aktive në parandalimin dhe rënien e krimit;
- Ngritjen e integritetit policor gjatë hetimit të veprave penale;
- Ngritjen e besimit të qytetarëve në autoritetet hetimore mbi luftimin e krimit;
- Sigurimin e një qasjeje parimore në respektimin e të drejtave dhe lirive të viktimave dhe personave të dyshuar.

## **2.7. Metodologjia e inspektimit**

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime-intervista me drejtues, punonjës, bartës funksionesh, përfshirë: shefat e sektorëve rajonal të hetimeve dhe zyrtarë policorë të dhomave të dëshmive;
- b) Janë kryer inspektime-kontrolle të: dosjeve hetimore, mostrave të dëshmive, kushteve fizike e të sigurisë në dhomat e dëshmive, si dhe të evidencave të rasteve hetimore;
- c) Janë marrë dokumente, si: kopjet e dosjeve (në secilin sektor rajonal hetimor janë marrë nga 10 dosje penale), raportet vjetore, kopjet e zinxhirëve të ruajtjes dhe evidencave, si dhe raportet e inventarizimit, të revizionit dhe inspektimit.

## **2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit**

2.8.1. Bazuar në Programin e punë inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 22.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 13.08.2019.

## **2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit**

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave nga sektorët përkatës hetimor gjatë periudhës dy vjeçare (2017-2018) dhe gjendjen aktuale të menaxhimit.

## **2.10. Drejtimit e inspektimit**

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Performanca e njësive hetimore rajonale në hetimin dhe zbulimin e krimit;
- Menaxhimi i dëshmive dhe sendeve të konfiskuara.

## **2.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- Ligji i Policisë;
- Rregullorja për Personel dhe Administratë;
- Rregullorja për Operativë;
- Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit;
- Procedura Standarde e Operimit të Teknikës Kriminalistike - Sektori i vendit të ngjarjes;
- Procedura Standarde e Operimit për Dhomën e dëshmive;
- Udhëzuesi për përmbajtjen dhe radhitjen e dosjes penale; dhe
- Dokumentet tjera relevante që rregullojnë fushën e hetimeve.

## **2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.



### **3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet**

---

#### **3.1. Performanca e njësive hetimore rajonale në hetimin dhe zbulimin e krimit**

3.1.1. Në kuadër të luftës kundër krimit, Prokuroria është e obliguar ta mbikëqyrë respektimin e ligjshmërisë, si organ zotërues në procedurë hetimore. Prokuroria e Shtetit ka të drejtë të kryejë çdo veprim hetimor, që e çmon të nevojshëm për të vërtetuar praninë e veprës penale. Policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi, mbajtjen e rendit e qetësisë publike, si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, andaj Policia ndërmer veprime hetimore dhe masa të nevojshme që të zbulojë veprat penale dhe kryerësit e tyre, që të grumbullojë informata të nevojshme për vendndodhjen e kryerësve të tyre, të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat që kontribuojnë në zbardhjen e kryerësve të veprave penale dhe të mbledhë informatat e nevojshme për paraqitje në procedurën penale. Për t'iu kundërvënë me sukses krimit, Policia ndërmer një varg aktivitete policore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave nga sektorët rajonal hetimor gjatë menaxhimit të rasteve që i kanë në kompetencë lëndore, IPK-ja ka siguruar një numër dosjesh hetimore nga secila drejtori rajonale. Janë kontrolluar dosje penale të proceduara në Prokuroritë kompetente me kallëzime penale apo me raporte të veçanta, me të cilat njoftohet Prokurori i Shtetit për veprat penale dhe kryerësit e tyre. Për të vlerësuar rregullësinë e lëndëve penale nëse ato përmbajnë dokumentet e formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin dhe dokumentimin e krimit, janë kontrolluar 80 lëndë, duke përfshirë nga dhjetë (10) sosh për secilin sektor rajonal. Është vlerësuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore, si dhe unifikimi i formularëve të përdorura brenda rasteve.

3.1.2. Nga momenti i marrjes së informatës për dyshimin për shkelje ligji, Policia dokumenton mbi veprimet e saj deri në momentin e procedimit të rastit në organin kompetent. Bazuar në nenin 70, paragrafi 5 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, pas pranimit të informatës për veprën penale të dyshuar, Policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, të jetë kryer. Policia është e detyruar që brenda 24 orëve t'i dorëzojë një raport policor Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendosë nëse duhet filluar procedurën penale. Lidhur me këtë, IPK ka kontrolluar dosjet penale të mostruara për të verifikuar nëse përmbajnë raportin policor. Inspektimi vë në pah se jo në të gjithë sektorët rajonal të hetimeve është përmbushur ky kriter, ngase në 75 dosje nga gjithsej 80 të kontrolluara, apo në 94% të tyre nuk është gjetur Raporti policor njoftues për Prokurorin, ashtu siç parashihet në nenin 70 të KPPK-së<sup>1</sup>. Mungesa e raportit me shkrim për Prokurorin e Shtetit, mbi dyshimin e arsyeshëm lidhur me veprën penale, vlerësohet se vjen nga neglizhenca e zyrtarëve policor për të hartuar raportet me shkrim mbi përshkrimin e dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale për të cilën janë në dijeni. Mosraportimi me shkrim i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale paraqet mosrespektim të nenit 70, paragrafi 5 të KPPK-së. Raste të tilla janë hasur edhe në të kaluarën kur edhe është rekomanduar, që Policia të sigurohet që në rrethanat kur vie deri tek 'dyshimi i arsyeshëm' se është kryer një vepër penale, brenda 24 orëve të respektohet dispozita ligjore nga KPPK-ja për të dorëzuar raportin policor njoftues për Prokurorin e Shtetit.

---

<sup>1</sup> Mitrovicë Veriu (në të gjitha lëndët), Mitrovicë Jugu (në të gjitha lëndët), Prishtinë (në të gjitha lëndët), Pejë (në 9 nga gjithsej 10 lëndë), Prizren (në 6 nga gjithsej 10 lëndë), Gjakovë (në të gjitha lëndët), Ferizaj (në të gjitha lëndët) dhe Gjilan (në të gjitha lëndët).

### **Rekomandimi nr. 1**

*IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të përmbushin obligimin e dalë nga neni 70, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sipas të cilit, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale, brenda 24 orëve duhet t'i dërgojë raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.*

3.1.3. Hetuesit policor që trajtojnë raste penale në kuadër të Sektorëve Rajonal të Hetimeve, në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësit e njësive duhet ta bëjnë një plan të hetimit, sipas të cilit do të zhvillohet procesi i hetimit të rastit. Inspektimi vë në pah se në 50 dosje të mostruara nga gjithsej 80 të kontrolluara, apo në 63% të tyre nuk janë hartuar Planet e hetimit, sipas të cilave do të duhej zhvilluar procesi i hetimeve<sup>2</sup>. Hetimi i rastit duhet të bëhet në një afat sa më të shkurtër e të arsyeshëm kohor, gjithnjë në koordinim të ngushtë me Prokurorin e Shtetit. Hetuesi me rastin e kompletimit të hetimit duhet të dërgojë lëndën për kontroll dhe nënshkrim tek Shefi i Njesisë së hetimeve, ngase nuk lejohet që të dërgohet në Prokurori pa nënshkrimin e tij apo zëvendësit<sup>3</sup>. Inspektimi vë në pah se në 49 dosje të mostruara për inspektim nga gjithsej 80 të kontrolluara, apo në 61% të tyre nuk figurojnë nënshkrimet e mbikëqyrësve të njësive<sup>4</sup>. Në këto raste nuk është respektuar zinxhiri komandues që dosjet hetimore t'i nënshtrohen kontrollit dhe më pas të nënshkruhen nga mbikëqyrësit e njësive. Kontrolli i dosjeve duhet bërë me qëllim që hetuesit e mbikëqyrësit të sigurohen se rastet janë kompletuar dhe për të eliminuar shmangiet nga veprimet e nevojshme, që shpiejnë në zbardhjen e fakteve dhe rrethanave të veprave penale. Vlerësohet se dobësitë e tilla janë rezultat i neglizhencës së hetuesve dhe mbikëqyrësve.

### **Rekomandimi nr. 2**

*IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e ngarkuar me raste penale, që të eliminohen dobësitë e identifikuar gjatë inspektimit që lidhen me mungesën e planeve të hetimit brenda rasteve të inicuar, si dhe kontrollin e pamjaftueshëm nga mbikëqyrësit gjatë procedimit të lëndëve tek organi i akuzës.*

3.1.4. Policia ka të drejtë të marrë në pyetje edhe personat, të cilët mund të jenë dëshmitarë të një veprë penale, si dhe persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale. Policia paraprakisht duhet t'i informojë palët për të drejtat që u takojnë gjatë marrjes në pyetje dhe përpilon raportin e marrjes në pyetje. Raporti duhet të përmbledhë pyetjet, përgjigjet, të identifikojë zyrtarin policor që ka marrë në pyetje të dyshuarin, kohën, datën, vendin dhe të identifikojë të dyshuarin. Gjatë ushtrimit të autorizimeve që rrjedhin si rezultat i detyrave dhe përgjegjësive të parapara me ligj, Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen e respektimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut. Bazuar në nenin 125 të KPPK-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i i lexon dëshmitarit - të dyshuarit, paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara dhe i njëjti duhet të konfirmojë me shkrim për të kuptuarit e tyre. IPK-ja ka analizuar respektimin e këtyre të drejtave në procedurë paraprake gjatë marrjes në pyetje të palëve. Në katër (4) dosje nga gjithsej 80 të

<sup>2</sup> Mitrovicë Veriu (në 5 nga 10), Mitrovicë Jugu (në 1 nga 10), Prishtinë (në 8 nga 10), Pejë (në 2 nga 10), Prizren (në 9 nga 10), Gjakovë (në 5 nga 10), Ferizaj (në të gjitha lëndët) dhe Gjiilan (në të gjitha lëndët).

<sup>3</sup> Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.

<sup>4</sup> Mitrovicë Veriu (në 7 nga 10), Mitrovicë Jugu (në të gjitha lëndët), Prishtinë (në 4 nga 10), Pejë (në 8 nga 10), Prizren (në 1 nga 10), Gjakovë (në 9 nga 10), Ferizaj (në 4 nga 10) dhe Gjiilan (në 6 nga 10).

kontrolluara, apo 5% të tyre, janë gjetur deklarata që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të të dyshuarve, gjegjësisht të dëshmitarëve<sup>5</sup>. Në disa prej deklaratave që i përmbajnë të drejtat e të intervistuarve, të drejtat nuk janë konform neneve të parapara në KPPK, mbi të drejtat e personit të dyshuar apo dëshmitarit. Kjo është evidentuar në 17 dosje nga gjithsej 80 të kontrolluara, apo 21% e tyre<sup>6</sup>. Është hasur edhe në deklarata që nuk janë nënshkruar nga marrësit e deklaratës. Në disa dosje të mostruara, ka raste kur procesverbalet e marrjes në pyetje nuk janë nënshkruar nga të dyshuarit-dëshmitarët<sup>7</sup> dhe kjo ka ardhur nga neglizhenca e hetuesve dhe mund të ketë efekte negative gjatë zhvillimit të fazave të mëvonshme të procedurës penale.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve, që me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo të dyshuarve, t'u lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe në fund të marrjes në pyetje, procesverbalet (deklaratat) të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.*

3.1.5. Analiza e dosjeve hetimore vë në pah se procesverbalet e marrjes në pyetje, kallëzimet penale, raportet e veçanta dhe shkresat tjera në përbërje të dosjeve, të përdorura brenda tyre nuk janë unike në kuadër të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve dhe nuk ka një standardizim të hartimit të tyre në të gjitha drejtoritë rajonale. Përkundër faktit se formularët standard të deklaratave mbi marrjen në pyetje të palëve, gjenden të qasshëm në kuadër të rrjetit elektronik të komunikimit të brendshëm policor (intranet), ende ka raste kur përdoren formularë të vjetër të procesverbaleve (deklaratave). Vlerësohet i paarsyeshëm aplikimi i formularëve të tillë dhe kjo në të ardhmen duhet eliminuar. Aplikimi i formularëve të standardizuar krijon kushte për përdorim uniform të dokumenteve, duke përmbushur një standard të pasqyrimin të të dhënave dhe duke lehtësuar apo mundësuar prezantimin e plotë të tyre. Mosaplikimi i formave unike ka ardhur nga neglizhenca e hetuesve, andaj duhet mobilizuar në standardizimin e shkresave të tilla operacionale.

### **Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit në mënyrë që gjatë kryerjes së veprimeve hetimore të aplikohen formularët unikë që janë të harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të krijimit të dosjeve të standardizuara hetimore.*

3.1.6. I dyshuari ka të drejtë në mbrojtës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale dhe para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit, Policia e njofton atë për të drejtën në angazhimin e mbrojtësit. Nga e drejta në mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastet e mbrojtësit të detyruar, nëse heqja dorë bëhet e qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë mbi të drejtën në mbrojtje. Mbrojtja ligjore për fëmijët viktimë bëhet përshtatshëm sipas nenit 63, paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së. Nga kontrolli i dosjeve është vlerësuar respektimi i dispozitave ligjore në deklaratat e të dyshuarve në rastet ku prezenca e avokatit mbrojtës ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës. Në të gjitha dosjet e kontrolluara është vlerësuar se dispozitat ligjore për të drejtën në mbrojtje janë zbatuar në harmoni me nenin 57 të KPPK-së. IPK-ja çmon angazhimet e hetuesve rajonal në respektimin e këtyre dispozitave ligjore.

<sup>5</sup> Mitrovicë Veriu (në 3 nga 10 raste ) dhe Prizren (në 1 nga 10).

<sup>6</sup> Prizren (në 4 nga 10), Gjakovë (në 5 nga 10) dhe Gjilan (në 8 nga 10).


<sup>7</sup> Mitrovicë Veriu (në 3 nga 10), Pejë (në 3 nga 10) dhe Gjakovë (në 1 nga 10).

3.1.7. Plani Strategjik Zhvillimor (2016-2020) i ka vënë objektiv specifik Policisë së Kosovës, ”Përmirësimin e ruajtjen e sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale”, në kuadër të të cilit objektiv parashihen aktivitete për zvogëlimin e rasteve kriminale dhe ngritjen e zbulueshmërisë. Drejtoritë Rajonale zhvillojnë aktivitete të ndryshme operative - hetimore për të parandaluar aktivitetin kriminal, për të kapur të dyshuarit dhe për të identifikuar rrugët përmes të cilave kryhen veprat kriminale. IPK-ja është interesuar për të matur performancën e Sektorëve Rajonalë të Hetimeve, duke i kushtuar rëndësi zbulueshmërisë së veprave penale dhe ngarkesës së hetuesve me raste penale, por kjo është vështirësuar përshkak se në raportet vjetore mungon informacioni mbi rastet e bartura nga vitet e kaluara, numri i të cilave është i lartë dhe brenda tyre ka raste të mbetura që nga viti 1999. IPK-ja do të trajtojë këtë problematikë në një të ardhme të afërt. Raportet standarde të drejtorive pasqyrojnë numrin e veprave penale të inicuar si raste të reja brenda vitit, numrin e veprave penale të zbuluara (veprat penale me kryes të njohur, veprat penale të zbuluara dhe veprat penale të mbyllura për shkaqe të ndryshme) dhe numrin e veprave penale të pazbuluara (veprat penale të dërguara me NN dhe veprat penale nën hetime). IPK-ja e vlerëson të nevojshme që formati i këtyre raporteve duhet të rishikohet, ngase nuk përmban të dhënat e nevojshme mbi veprat penale dhe zbulueshmërinë. Format i rishikuar duhet pasqyrojë edhe indikatorët shtesë që masin performancën dhe efikasitetin e këtyre Sektorëve.

3.1.8. IPK-ja ka analizuar trendin e zhvillimit dhe luftimit të krimit, zbulueshmërinë e veprave penale dhe efikasitetin e njërive në trajtimin e rasteve të inicuar brenda vitit kalendarik, por jo dhe atyre të bartura. Numri i rasteve të kategorizuara si vepra penale në kompetencë të Sektorëve Rajonalë ka shënuar rënie gjatë vitit 2018 për 9% krahasuar me një vit më parë. Tre Sektorë Rajonalë kanë evidentuar numër më të madh të rasteve (Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë-Jugu). Prishtina prinë me numrin më të madh të veprave penale përgjatë dy viteve, duke u përfaqësuar me 43%, përkatësisht 47% të të gjitha rasteve në nivel të të gjithë Sektorëve Rajonal. Gjakova ka regjistruar numrin më të vogël të rasteve përgjatë dy viteve. Nga analiza e ngarkesës së hetuesve me raste, del se gjatë vitit 2017 përgjithësisht një hetues rajonal ka administruar mesatarisht pesë (5) raste të inicuar gjatë vitit, derisa në vitin 2018, kjo ngarkesë bie në katër (4) raste. Gjatë vitit 2017 dhe 2018, ngarkesën më të madhe me raste e kanë patur hetuesit rajonal të Prishtinës ku çdonjëri nga ta ka administruar mesatarisht nga nëntë (9) raste për vit. Gjatë vitit 2017 e 2018, ngarkesë më të vogël kanë patur hetuesit rajonal të Gjakovës, përkatësisht Gjilanit. Çdonjëri prej hetuesve të Gjakovës gjatë vitit 2017 ka administruar mesatarisht dy (2) raste. Gjatë vitit 2018, çdonjëri prej hetuesve rajonal të Gjilanit ka administruar po ashtu mesatarisht dy (2) raste.

<b>Tabela nr. 1 - Trendet e kriminalitetit dhe indikatorët e performances dhe efikasitetit të SRH-ve</b>										
<b>Sektorët Rajonal Hetimor</b>	<b>Numri i hetuesve</b>		<b>Vepra penale</b>		<b>Të zbuluara</b>		<b>Ngarkesa për polic</b>		<b>Të zbuluara për hetues</b>	
	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
Prishtinë	62	61	567	561	413	399	9.15	9.20	6.66	6.54
Pejë	35	36	107	124	87	100	3.06	3.44	2.49	2.78
Prizren	29	29	148	103	43	76	5.10	3.55	1.48	2.62
Ferizaj	26	30	178	97	157	82	6.85	3.23	6.04	2.73
Gjilan	28	30	93	72	77	52	3.32	2.40	2.75	1.73
Gjakovë	18	16	39	60	29	56	2.17	3.75	1.61	3.50
Mitrovicë Jugu	26	28	116	127	82	93	4.46	4.54	3.15	3.32
Mitrovicë Veriu	18	23	80	61	57	44	4.44	2.65	3.17	1.91
<b>Gjithsej</b>	<b>242</b>	<b>253</b>	<b>1.328</b>	<b>1.205</b>	<b>945</b>	<b>902</b>	<b>5.49</b>	<b>4.76</b>	<b>3.90</b>	<b>3.75</b>

3.1.9. Njësitë policore kryejnë veprime hetimore në kuadër të autorizimeve të Prokurorisë së Shtetit. Përçdo hetim penal, Policia dërgon apo njofton Prokurorinë me rezultatin e hetimeve, duke dorëzuar kallëzim penal kur ka dyshim të arsyeshëm për kryerje të veprës penale, apo raport të veçantë kur nuk ka prova për të siguruar një dyshim të arsyeshëm se një veper penale është kryer. Pas dërgimit të rasteve me kallëzim penal në Prokurori, njësitë hetimore njoftohen vetëm në rastet kur hudhen kallëzimet, por jo edhe me vendimet tjera kur rastet përfundojnë me ngritje të aktakuzës apo edhe epilogun e vendimeve të gjykatave kompetente. IPK-ja vlerëson se shkalla e zbulueshmërisë së rasteve dhe efikasiteti i njësive hetimore është problematike për t'u vlerësuar për vetë faktin se rastet e përfunduara me kallëzime penale në Prokurori, domosdo nuk përfundojnë me ngritje të aktakuzave apo dënimin e kryerësve të veprave penale. Nga analiza e raporteve, vërehet se rastet e dërguara në Prokurori me kallëzime penale me kryes të njohur janë kategorizuar si të zbuluara. Nëse krahasojmë numrin e veprave penale të administruar me numrin e rasteve të zbuluara, gjatë vitit 2018 është shënuar një trend pozitiv i përcjellur me ngritjen e zbulueshmërisë së rasteve në kuadër të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve për 3% krahasuar me një vit më parë (nga 71% në 74%). Ferizaj ka pasur shkallën më të lartë të zbulueshmërisë gjatë vitit 2017 me 88%, kurse Prizreni, shkallën më të ulët me 29%. Gjatë vitit 2018, Gjakova ka pasur shkallën më të lartë të zbulueshmërisë me 93%, derisa Prishtina, shkallën më të ulët me 71%.



3.1.10. Fokus i veçantë i inspektimit ka qenë vlerësimi i performances së njësive hetimore, nëse kanë qenë efikase në angazhimet hetimore në raport me objektivat që dalin nga Plani Strategjik. Janë analizuar statistikat mbi raportin e rasteve të pazbuluara kundrejt atyre të zbuluara. Sa më e thellë që të jetë diferenca ndërmjet rasteve të pazbuluara kundrejt atyre të zbuluara, përbën gjasa me probabilitet pozitiv për efikasitet në ngritjen e zbulueshmërisë dhe përmbushjen e objektivave që dalin nga Plani Strategjik. Mbi bazën e këtij vlerësimi, nëse e krahasojmë diferencën e numrit të rasteve të pazbuluara në raport me rastet e zbuluara, gjatë vitit 2017, përgjithësisht në nivel të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve, numri i rasteve të pazbuluara me numrin e rasteve të zbuluara qëndron në raportin 1 me 2.47. Në vitin 2018, ky raport është përmirësuar në 1 me 2.98 (afërsisht çdo i katërti rast ka qenë i pazbuluar gjatë vitit). Gjatë vitit 2017, Ferizaj ka pasur diferencën më të thellë të numrit të rasteve të pazbuluara në raport me ato të zbuluara (1 me 7), derisa Prizreni ka pasur diferencën më të vogël të numrit të rasteve të pazbuluara në raport me ato të zbuluara. Kjo nënkupton se Prizreni ka patur më shumë raste të pazbuluara se sa të zbuluara (1 me 0.4). Gjatë



vitit 2018, Gjakova ka pasur diferencën më të thellë të numrit të rasteve të pazbuluara në raport me ato të zbuluara (1 me 14), derisa Prishtina e Gjilani kanë pasur diferencën më të vogël të numrit të rasteve të pazbuluara në raport me ato të zbuluara (1 me 2). Duhet të analizohen këto diferenca, ngase trendët në disa Sektorë paraqesin prezencë të lartë të rasteve të pazbuluara gjatë vitit dhe mund të mos garantohet siguri në përmbushjen e objektivave për luftimin e krimit dhe ngritjen e zbulueshmërisë. Sektorët Rajonalë të Hetimeve në DRP-Prizren, Mitrovicë Veriu, Mitrovicë Jugu dhe Prishtinë duhet të analizojnë shkallën aktuale të zbulueshmërisë, për të identifikuar shkaktarët që kanë për rrjedhojë këtë shkallë të efikasitetit në luftimin e krimit. Duhet patur parasysh se tek Prishtina ka ndikuar edhe numri më i madh i rasteve, me të cilat janë ngarkuar hetuesit rajonal.

Sektorët Rajonalë Hetimor	Numri i veprave penale		Numri i veprave penale të zbuluara		Raporti (të pazbuluara kundrejt të zbuluara)	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Prishtinë	567	561	413	399	1:2.68	1:2.46
Pejë	107	124	87	100	1:4.35	1:4.17
Prizren	148	103	43	76	1:0.41	1:2.81
Ferizaj	178	97	157	82	1:7.48	1:5.47
Gjilan	93	72	77	52	1:4.81	1:2.60
Gjakovë	39	60	29	56	1:2.90	1:1.14
Mitrovicë Jugu	116	127	82	93	1:2.41	1:2.74
Mitrovicë Veriu	80	61	57	44	1:2.48	1:2.59
<b>Gjithsej</b>	<b>1.328</b>	<b>1.205</b>	<b>945</b>	<b>902</b>	<b>1:2.47</b>	<b>1:2.98</b>

### 3.2. Menaxhimi i dëshmive dhe sendeve të konfiskuara

3.2.1. Administrimi i dëshmive është sfidë dhe preokupim i institucioneve të zbatimit të ligjit. KPPK dhe aktet tjera nënligjore përcaktojnë detyrat dhe autorizimet policore lidhur me trajtimin e dëshmive që nga sekuestrimi apo konfiskimi i tyre e deri te procedimi i tyre final<sup>8</sup>. Operacionet policore shpesh përcillen me gjetjen dhe konfiskimin e sendeve në vend ngjarje. Një nga detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë është gjetja dhe ruajtja e provave të veprave penale që mund të përdoren në procedurë penale, dhe të cilat konsiderohen si hallka kryesore që lidhë të dyshuarin me krimin. Ashtu siç vihet në vështirësi për të gjetur provat, nëpër të njëjtat vështirësi kalon Policia edhe për t'i ruajtur ato. Për sistemimin, vendosjen dhe ruajtjen e dëshmive duhet të ofrohen hapësira fizike dhe kushte të përshtatshme. Dhomat e dëshmive funksionojnë në kuadër të stacioneve policore, drejtorive rajonale, drejtorive rajonale kufitare dhe në nivel qendror. IPK ka inspektuar Dhomat e dëshmive në nivel të drejtorive rajonale. Në bazë të Programit të punës, inspektorët kanë përpiluar Pyetësorin bazuar në kriteret e parapara me Procedurën Standarde të Operimit për të vlerësuar kushtet e ruajtjes, trajtimit, akomodimit dhe evidentimit të dëshmive. Pyetësori ka përfshirë një proces verifikimi për të vërtetuar nëse trajtimi i dëshmive është bërë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Me synimin e arritjes së objektivave të inspektimit janë vizituar tetë (8) Dhoma të dëshmive dhe në secilën prej tyre janë kontrolluar kushtet e sigurisë, sistemimit, akomodimit, paketimit, ruajtjes dhe evidentimit. Në këtë drejtim janë përzgjedhur nga dhjetë (10) dëshmi në mënyrë rastësore për secilën Dhomë.

<sup>8</sup> Procedura Standarde e Operimit për Dhomat e dëshmive - Vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara në nivel lokal dhe qendror të Policisë së Kosovës, nr. referues ZDPO-02/008/14.

3.2.2. Dëshmitë duhet trajtuar me kujdes për të parandaluar humbjen, dëmtimin, shkatërrimin, kalbjen apo kontaminimin e tyre. IPK-ja ka gjetur që disa nga Dhomat e dëshmimeve nuk kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me PSO. Janë gjetur dëshmi, të cilat nuk kanë qenë duke u ruajtur të ndara në vende të posaçme varësisht nga specifikat e tyre<sup>9</sup>. Në DRP-Ferizaj është gjetur që paratë e konfiskuara, të cilat janë dorëzuar për ruajtje në Dhomën e dëshmimeve, nuk janë gjetur brenda zonës së deponimit dhe mbahen në një sef në zyrën e Zyrtares përgjegjëse të Dhomës së dëshmimeve që gjendet në katin më lartë të objektit ku është e vendosur Dhoma e dëshmimeve. Kjo hapësirë ndahet edhe me zyrtarë tjerë të drejtorisë. Mbajtja e këtyre parave të konfiskuara jashtë Dhomës së dëshmimeve, ku qasja e personelit tjetër policor nuk është kufizuar, vlerësohet si ruajtje, trajtim joadekuat i dëshmimeve dhe në kundërshtim me kapitullin V, pika C, paragrafi 1 të PSO-së<sup>10</sup>, duke cenuar dhe rrezikuar nivelin e sigurisë së tyre.

#### **Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmimeve në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore - Ferizaj që të gjitha dëshmitë dhe sendet e konfiskuara të ruhen brenda hapësirave të Dhomës së dëshmisë, kurse bankënotat dhe gjërat e çmuara të deponohen në sef apo arkë metali brenda zonës së deponimit të sendeve dhe dëshmimeve.*

3.2.3. Mostrat biologjike, drogat në formë të lëngshme, përmbajtjet në shiringa, brisqet e rrojes, si dhe paratë/bankënotat janë dëshmi, të cilat duhet të ruhen në vende të posaçme dhe të ndara nga dëshmitë tjera. Në Dhomat e dëshmimeve në DRP-Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Jugu dhe Mitrovicë Veriu janë gjetur mostra biologjike, të cilat nuk ruhen në frigorifer, kurse në DRP-Prizren, njëra (1) nga dhjetë (10) dëshmitë e inspektuara (mostër biologjike) është gjetur pa shirit bllombues. Ruajtja e dëshmimeve (parave dhe mostrave biologjike) në këto hapësira, të cilat janë të dedikuara për deponimin e dëshmimeve, si dhe pranimi i dëshmimeve në formë të hapur, pa shiritin bllombues që siguron që dëshmia të mos preket, apo të mos hapet pa respektimin e procedurave të përcaktuara, nuk e plotësojnë nivelin e kërkuar të sigurisë për dëshmitë, të cilat vlerësohen të jenë të profilit të lartë të ndjeshmërisë. Ruajtja dhe trajtimi i tillë i mostrave biologjike vlerësohet të ketë ardhur nga neglizhenca e Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve.

#### **Rekomandimi nr. 6**

*IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore, që me rastin e pranimi të dëshmimeve nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të mbyllura dhe të paketuara në paketime adekuate, dhe të njëjtat të ruhen në vende të posaçme, varësisht nga specifikat, me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet e mundshme.*

3.2.4. Jo të gjitha dëshmitë duhet ruajtur brenda dhomës së deponimit të dëshmimeve. Bazuar në kapitullin V, pika C, nënpikat 3 e 4 të PSO-së, sendet dhe dëshmitë e rrezikshme (eksplozivët, materiet radioaktive, mjetet zjarrëvënëse, materialet helmuese apo ndonjë materie kimike tjetër të natyrës së dëmshme) nuk guxojnë të deponohen në Dhomën e dëshmimeve. Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmimeve duhet menjëherë të kërkojë transferimin e tyre në lokacionet e destinuar për

<sup>9</sup> Në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu dhe Prizren.

<sup>10</sup>Dhoma për ruajtjen e sendeve, pasurisë, provave apo parave të gjetura është dhomë e caktuar dhe e siguruar mirë ku vendosen, trajtohen dhe ruhen sendet, pasuria apo paratë e gjetura, të falsifikuara apo të sekuestruara, të cilat janë nën administrimin e njëjësive hetimore të stacioneve policore, drejtorive rajonale policore dhe në nivel qendror.

to. Materiet e tilla janë hasur në Dhomën e dëshmime në DRP-Prishtinë (bombola të gasit të mbushura me N<sub>2</sub>O), si dëshmi të konfiskuara që lidhen me rastin nr. 2017-AS-040. Këto dëshmi nuk duhet të qëndrojnë në hapësirat e Dhomës së dëshmime pasi paraqesin rrezik për dëshmitë tjera dhe zyrtarët policor që ushtrojnë aktivitetet e tyre.

#### **Rekomandimi nr. 7**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit Rajonal të Prishtinës, që të ndërmarr veprimet e nevojshme për largimin e materialeve të rrezikshme nga hapësirat e Dhomës së dëshmime dhe në të ardhmen, deponimi i llojeve të tilla të bëhet në përputhje me Procedurën Standarde të Operimit.*

3.2.5. Procedura Standarde e Operimit për Dhomat e dëshmime ka përcaktuar rregullat në rastet kur dëshmia në kuti/paketim apo zarf të mbyllur duhet të hapet. Në këto situata duhet regjistruar në regjistër special, data, arsyeja dhe emri i policit që hapë dëshminë. Vetëm shefi i hetuesisë ose zëvendësi i tij, bashkë me një zyrtar të dëshmime, janë të autorizuar me rihapë kutinë/paketimin. IPK ka përzgjedhur dëshmi në baza rastësore nga Regjistri i dëshmime dhe ka inspektuar nëse ato janë të mbyllura. Për rastet e hapjes së dëshmime është verifikuar respektimi i procedurës për regjistrimin special. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Gjilan janë gjetur dëshmi (pistoletë me një karikator dhe një fishek, si dhe dy mostra të mbetjeve të barutit të marra nga duartë e viktimës që lidhen me veprën penale "Vdekje e dyshimtë"<sup>11</sup>), të cilat kanë qenë të hapura dhe për të cilat nuk është bërë regjistrimi special. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Mitrovicë Jugu nga dhjetë (10) dëshmitë e inspektuara, një (1) prej tyre është gjetur e hapur (një telefon NOKIA me ngjyrë të zezë). Dëshmia është konfiskuar pasi dyshohet që lidhet me veprën penale "Vrasje e rëndë në tentativë"<sup>12</sup>, por për hapjen e saj nuk është bërë regjistrimi special. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Ferizaj, po ashtu është gjetur që dëshmia (armë e zjarrit AK-47) e konfiskuar nën dyshimin se lidhet me veprën penale "Armëmbajtje pa leje"<sup>13</sup> ka qenë e hapur dhe për të njëjtën, nuk është respektuar procedura e regjistrimit special mbi hapjen. Lëshimet në respektimin e procedurave të hapjes cenojnë identitetin e tyre dhe mund të sjellin pasoja në procedurat e mëtejme hetimore.

#### **Rekomandimi nr. 8**

*IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmime në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore, tek të cilat janë evidentuar rastet e hapjes së dëshmime, që në asnjë rast të mos hapen dëshmitë pa u respektuar plotësisht Procedura Standarde e Operimit për Dhomat e dëshmime, që parasheh procedurën e evidentimit special për rastet kur hapen kutitë/paketimet.*

3.2.6. Në kuadër të vendosjes, paketimit dhe ruajtjes së dëshmime, Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmime duhet të orvatet që të shfrytëzojë një zonë të posaçme të caktuar si zonë deponimi për lloje të caktuara dëshmesh. Armët e zjarrit, narkotikët, dëshmitë e rasteve të vrasjeve duhet të vendosen në lokacione më larg hyrjes së zonës së deponimit, që të jenë më të sigurta si dëshmi apo prova materiale. Gjatë inspektimit është parë që dëshmitë në DRP-Mitrovicë Jugu janë të vendosura jo konform këtij kriteri të përcaktuar në PSO. Dhoma e dëshmime është e ndarë në dy pjesë dhe në dhomën e parë tek dera hyrëse janë deponuar armët e zjarrit, që sipas rregullit duhet të deponohen në zona më të thella të deponimit. Kjo pjesë nuk monitorohet përmes kamerave.

<sup>11</sup> Numri i rastit NJHR0016-17.

<sup>12</sup> Numri i rastit 2018-BI-050.

<sup>13</sup> Numri i rastit 2016-CFI-004.



Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmimeve duhet të përpiqet që dëshmitë të vendosen në hapësira më të thella të zonës së deponimit, në mënyrë që atyre të mos u cenohet siguria.

3.2.7. Me rastin e dorëzimit të dëshmisë, Lista e dëshmimeve e Zinxhiri i ruajtjes duhet plotësuar në mënyrë të duhur duke përmblajtur informatat që përshkruajnë dëshmitë, të dhënat e personit që e ka gjetur-dorëzuar, apo konfiskuar, datën dhe kohën. Informatat mbi dëshmitë duhet të jenë të dokumentuara në regjistrin e dëshmisë dhe të përmbajë të dhënat mbi kohën e pranim-dorëzimit, njësinë hetuese, numrin e rastit, llojin e veprës penale, informatat për policin që dorëzon-pranon dëshminë, përshkrimin e çdo mjeti, përfshirë numrin e mjetit, numrin serik, shenjën klasifikuese, etj. Pas regjistrimit në Regjistrin e dëshmimeve, informata në mënyrë ekuivalente transferohet në databazë kompjuterike. Çdo lëvizje e sendit apo dëshmisë, të dorëzuar në gjykatë apo njësi tjetër, që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, regjistrohet në Regjistrin e dëshmimeve dhe në Bazën e të dhënave të menaxhimit të dëshmimeve. Në rast se sendi dhe dëshmia është dorëzuar për ekzaminim/analiza në laboratorin kriminalistik, kjo lëvizje regjistrohet në Regjistër të dëshmimeve dhe databazë. Në rast kur dëshmitë me urdhëresë me shkrim kërkohen nga Gjykata - Prokuroria, dorëzohen për ekzaminim/analiza apo ri-ekzaminim në laborator, kjo duhet të regjistrohet në Regjistër dhe databazë, dhe për të njëjtën duhet të bashkangjitet kopja e raportit të ekzaminimit, e cila duhet të ruhet në dosjet e Dhomës së dëshmimeve. Për të vërtetuar rregullësinë e mbajtjes së këtyre evidencave është verifikuar nëse janë bërë regjistrimet në mënyrë ekuivalente në regjistra. Të gjitha Dhomat mbajnë Regjistrat fizikë të dëshmimeve dhe databazat elektronike. Por janë hasur parregullësi në regjistrimin e dëshmimeve në këto dy lloj regjistrash. Në Dhomat e dëshmimeve në DRP-Prishtinë dhe Gjilan janë gjetur të jenë të regjistruara në Regjistra më shumë dëshmi se sa që janë pranuar, duke pasur mospërputhje të dhënash në mes Regjistrit e Zinxhirit të ruajtjes<sup>14</sup>. Në DRP-Gjilan, Gjakovë e Prishtinë po ashtu janë evidentuar raste kur dëshmitë e deponuara në Dhomat e dëshmimeve nuk kanë qenë të regjistruara në databazën kompjuterike<sup>15</sup>.

3.2.8. Zinxhiri i ruajtjes së sendit, pasurisë, provës apo parasë së gjetur është dokument apo formular i domosdoshëm që evidenton-prezenton konfiskimin, pranim-dorëzimin, ekzaminimin, lëvizjet, vendosjen dhe ruajtjen e sendeve dhe dëshmimeve, si dhe prezencën apo qasjen e zyrtarëve policor. Origjinali i formës së "Zinxhirit të ruajtjes" duhet të mbetet në Dhomën e dëshmimeve së bashku me sendin/dëshminë, ndërsa kopja, në dosjen e dëshmisë. Gjatë inspektimit janë hasur dy raste kur dëshmitë janë deponuar në Dhomat e dëshmimeve dhe nuk u janë bashkangjitur zinxhirët e ruajtjes. Në Dhomat e dëshmimeve në DRP-Mitrovicë Veriu dhe Gjakovë janë identifikuar dy (2) raste kur nuk janë prezentuar zinxhirët e ruajtjes për dëshmitë e deponuara<sup>16</sup>. Në DRP-Gjilan dhe Ferizaj, Lista e dëshmimeve dhe Zinxhiri i ruajtjes nuk janë plotësuar në mënyrë të duhur, duke mos i përmblajtur të gjitha informatat<sup>17</sup>. Në Dhomat e dëshmimeve në Gjilan dhe Prishtinë janë vërejtur mungesa të informatave të nevojshme në regjistrim, duke mos u bërë përshkrimi i çdo dëshmie (numri i mjetit, numri serik dhe shenja klasifikuese sipas specifikave që i ka përmblajtur zinxhiri i ruajtjes)<sup>18</sup>. Evidentimi i dëshmimeve duke përdorur shkurtesa të emërtimeve për dëshmitë, dhe duke

<sup>14</sup> Dëshmitë e rasteve me nr. 2018-AC-0712 (DRP-Prishtinë); 001617 (DRP-Gjilan).

<sup>15</sup> Dëshmitë e rasteve me nr. 2019-CA-002,0040-19, 0056-18, 011-19, 009-19 (DRP-Gjilan); 2017-EB-295 (DRP-Gjakovë) dhe 2018-AD-0035 (DRP-Prishtinë).

<sup>16</sup> Rastet me nr. 2016-SG-076 (DRP-Mitrovicë Veriu) dhe 2016-EA-1310 (DRP-Gjakovë).

<sup>17</sup> Rastet me nr. 040-19, 0056-18, 011-19, 009-19 (DRP-Gjilan); 2017-CF-2015, 2016-CF-1947 (DRP-Ferizaj).

<sup>18</sup> Rastet nr. 0038-17 (DRP-Gjilan), 2018-AC-1428, 2019-AB-0744, 2018-AB-2013, 2017-AS-041 (DRP-Prishtinë)

mos bartur specifikat dhe shenjat klasifikuese të tyre nga zinxhiri i ruajtjes në regjistra është rezultat i mungesës së vullnetit të zyrtarëve përgjegjës të Dhomave për të respektuar rregullat e përcaktuara për evidentimin dhe prezentimin e dëshmimeve.

#### **Rekomandimi nr. 9**

*IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve që me rastin e regjistrimit të sendeve/dëshmimeve të plotësojnë të dhënat e tyre në mënyrë ekuivalente në Regjistër dhe në databazë kompjuterike, duke përshkruar çdo dëshmi me specifikat dhe shenjat klasifikuese.*

3.2.9. Evidencën për sistemimin, emërtimin e raftit dhe lokacionin e dëshmisë duhet ta mbajë Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmimeve, i cili duhet të jetë në gjendje për të identifikuar dhe dokumentuar lokacionin e çdo dëshmie të deponuar, e që është një hap me rëndësi në funksion të ruajtjes dhe prezentimit të shpejtë të tyre. Lidhur me këtë, të gjitha kutitë e metalta, raftet dhe kabinetet duhet të kenë adresë të qartë lexuese. Ky evidentim garanton se i gjithë lokacioni është i shënuar-evidentuar në mënyrë të duhur, duke shfrytëzuar sistem numerik të organizuar që është specifik si një element i vlefshëm i sistemit<sup>19</sup>. Jo të gjitha Dhomat kanë të rregulluar evidencat mbi sistem numrash, emërtimin e raftit dhe udhëzime të tjera të qarta mbi lokacionin e dëshmisë. Dhomat e dëshmimeve në DRP-Gjilan e Mitrovicë Jugu nuk kanë plotësuar këtë kriter të përcaktuar me PSO. Zyrtarët përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve në Pejë, Gjilan, Mitrovicë Veriu, Prizren e Ferizaj nuk kanë qenë të gjendje të lokalizojnë shpejt disa nga dëshmitë e inspektuara. Kontrolli i dëshmimeve për të verifikuar nëse ato kanë të evidentuar numrin e sirtarit apo të kutisë në Regjistër, nxjerrë në pah që Dhomat e dëshmimeve në DRP-Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë Jugu, nuk kanë të evidentuar në Regjistër, lokacionin e dëshmisë brenda Dhomave të deponimit. Mirëpo, në databazë, zyrtarët përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve në DRP-Prishtinë, Ferizaj e Mitrovicë Jugu kanë evidentuar secilin lokacion të dëshmimeve. Dëshmitë që janë shkatërruar me urdhëresa, apo që kanë qenë në laborator për ekzaminim, janë konsideruar se kanë përmbushur standardin e përcaktuar me PSO.

3.2.10. Çdo lëvizje e dëshmisë, e dorëzuar në gjykatë, në ndonjë njësi tjetër, ose që i është kthyer pronarit apo personit të autorizuar, duhet të regjistrohet në Regjistër dhe databazën kompjuterike. Gjatë inspektimit të dëshmimeve të përzgjedhura nga inspektorët, ka rezultuar që të gjitha Dhomat e dëshmimeve kanë pasur mangësi në evidentimin e lëvizjeve të dëshmimeve. Në DRP-Gjilan, nëntë (9) nga dhjetë (10) dëshmi, në Gjakovë tetë (8) nga dhjetë (10) dëshmi, në Mitrovicë Jugu katër (4) nga dhjetë (10) dëshmi, në Prishtinë katër (4) nga dhjetë (10) dëshmi, në Mitrovicë Veriu tre (3) nga dhjetë (10) dëshmi, në Prizren dy (2) nga dhjetë (10) dëshmi dhe në Ferizaj një (1) nga dhjetë (10) dëshmi të kontrolluara, nuk i kanë të evidentuara lëvizjet e tyre në Regjistra. Është përgjegjësi e Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmimeve që të regjistrojnë secilat lëvizje të dëshmimeve, me të gjitha informatat mbi pranim-dorëzimin dhe procedurat tjera, të cilave iu janë nënshtruar për t'iu shmangur humbjeve apo dëmtimeve.

3.2.11. Qasja në Dhomë të dëshmimeve si dhe në të gjitha zonat e deponimit është e kufizuar vetëm për zyrtarët policor të Dhomës së dëshmimeve. Çdo hyrje e personelit regjistrohet në Regjistrin e

<sup>19</sup> PSO, dhomat e dëshmimeve-vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, në nivel lokal e qendrorë të Policisë së Kosovës, fq.12.

qasjes në Dhomën e dëshmime. Regjistri është gjetur në të gjitha Dhomat e dëshmime. Përgjegjës për plotësimin e tij është Zyrtari përgjegjës i Dhomës së dëshmime. Askush tjetër nuk duhet të ketë qasje në çelësin e Dhomës së dëshmime, përveç Komandantit të Stacionit, Drejtorit Rajonal dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithëshëm për Operativë<sup>20</sup>. Inspektorët kanë verifikuar se si ruhen çelësat nga menaxherët dhe kanë gjetur që vetëm Drejtorët Rajonal në Prizren, Gjakovë, Pejë, si dhe Komandanti i Stacionit Policor në Mitrovicë Veriu kanë respektuar procedurën e kufizimit të qasjes në çelësat e Dhomave të dëshmime. Drejtori Rajonal në Prishtinë, Mitrovicë Jugu, Ferizaj dhe Gjilan nuk kanë respektuar kriteret për mbajtjen e çelësve të Dhomave të dëshmime, në zarf të mbyllur siç përcaktohet me PSO.

3.2.12. Dhomat e dëshmime duhet të jenë të siguruara mirë, ngase në to vendosen, trajtohen dhe ruhen sendet apo pasuria e konfiskuar, të cilat janë nën administrimin e njëjësive hetimore të DRP-ve. Dhomat e dëshmime duhet të jenë të vendosura në vend të përshtatshëm brenda ndërtesave, të ndërtuara nga materiali i fortë, si blloqe betoni ose të ngjajshme. Duhet të jenë të projektuara pa dritare, për ndryshe dritaret duhet të konstruktohen ashtu që të pamundësojnë hyrjen përmes tyre, po ashtu kondicionimi dhe tubat e sistemit ventilues nëse ekzistojnë në dhoma, duhet të jenë të konstruktuar që të pamundësohet hyrja përmes tyre. Dyert e Dhomave të dëshmime preferohet të jenë të punuara apo përpunuara nga metali, kapëset nyjore të tyre duhet të jenë të montuara nga brendësia e dhomës. Inspektimi ka vënë në pah që gjashtë (6) nga tetë (8) dhomat e kontrolluara janë të vendosura në hapësira të përshtatshme brenda objekteve, të vlerësuar si hapësira të sigurta dhe të veçanta brenda tyre. Kurse, dy (2) dhoma nuk janë të vendosura në vend të përshtatshëm brenda objekteve. Në DRP-Prishtinë, Dhoma e dëshmime është e vendosur në bodrum të objektit. Për të shkuar tek Dhoma e dëshmime ekzistojnë dy qasje (drejtime), njëra nga brenda objektit dhe tjetra nga pjesa e prapme e objektit. Kjo qasje nuk ofron nivelin e duhur të sigurisë për dëshmitë që ruhen aty. Dhoma e dëshmime në DRP-Gjilan është e vendosur në bodrum të objektit dhe nuk ofron kushtet minimale të ruajtjes. Është e vendosur në vend të papërshtatshëm brenda objektit, ka nivel të lartë të lagështisë, kundërmon aromë të rëndë, papastërtia është e dukshme, muret e saj janë të dëmtuara dhe ndriçimi është tejet i dobët për shkak të instalimit të dobët. Këto kushte pamundësojnë zhvillimin e një procesi të rregullt të punës. Vendet e papërshtatshme dhe kushtet jo cilësore rrezikojnë dëshmitë si prova materiale dhe do ta bënin të papranueshme procedurën e mëtejme e cila lidhet me vargun e një sistemi të tërë të drejtësisë. Dëshmitë e trajtuara në mënyrë jo të duhur humbin vlerë dhe mund të shkatërrohen. Menaxhmenti i DRP-Gjilan duhet të veprojë menjëherë në trajtimin e duhur të dëshmime.

#### **Rekomandimi nr. 10**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit Rajonal të Gjilanit që në koordinim me Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve, që në afatin sa më të shkurtër kohor, të dislokojë dëshmitë në një hapësirë tjetër të përshtatshme, e cila do t'i plotësonte kushtet e vendosjes dhe ruajtjes së sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, me qëllim të shmangies së tyre nga dëmtimi dhe humbja e vlerës.*

<sup>20</sup> PSO, dhomat e dëshmime-vendosja, trajtimi dhe ruajtja e sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, në nivel lokal e qendrorë të Policisë së Kosovës, fq.22.

3.2.13. Nga tetë (8) Dhoma të dëshmime të inspektuara, vetëm njëra nga to është e konstruktuar pa dritare dhe shumica prej tyre kanë dritare të konstruktura që të pamundësojnë qasjen përmes tyre. Sa i përket ngrohjes, kondicionimit dhe tubave të sistemit ventilues që janë të rëndësishme për mbajtje të dëshmime në gjendje të përshtatshme, shtatë (7) nga tetë (8) dhomat e inspektuara kanë sistem të ventilimit. Por edhe pse ekziston sistemi ventilues në DRP-Gjilan dhe Prizren, ai nuk është funksional. Në Gjilan ventilimi nuk është funksional gjatë tërë kohës, kurse në Prizren në momentin e inspektimit ai ka qenë jashtë funksionit. Dhoma e dëshmime në DRP-Gjakovë nuk ka të instaluar një sistem të tillë. Në dhomat, në të cilat është i vendosur sistemi i kondicionimit, ngrohjes e ventilimit, janë të konstruktura që të pamundësojnë qasjet e paautorizuara.

3.2.14. Dyert e Dhomave të dëshmime preferohet të jenë të punuara apo përpunuara nga metali, ose të jenë derë solide nga bërthama e drurit, kurse kapëset nyjore të tyre të jenë të montuara nga brendësia e dhomës. Në gjashtë (6) nga tetë (8) dhoma të inspektuar, dyert e tyre kanë qenë sipas standardeve të kërkuara, ndërsa dy (2) dhoma tjera nuk kanë dyer sipas standardit. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Prishtinë, dera e saj është nga materiali i fortë. Kapëset nyjore të derës janë të vendosura nga pjesa e jashtme e Dhomës. Në DRP-Gjakovë, dera e Dhomës është e punuar nga druri, por e siguruar edhe me një derë metalike në formë rrjete, ndërsa kapëset nyjore po ashtu nuk janë të siguruar, ngase janë të vendosura nga ana e jashtme e Dhomës.

3.2.15. Planifikimi i Dhomës së dëshmime varet nga hapësira që ka në dispozicion, standardet e punës dhe vëllimi i dëshmime që duhet deponuar. Por, pavarësisht nga madhësia, një standard minimal i caktuar duhet të jetë i përfshirë gjatë dizajnit - planifikimit të Dhomës së dëshmime. Dhomat duhet të jenë cilësore dhe të përshtatshme për të shfrytëzuar pajisjet dhe për të vendosur rafte, dollapë, etj. Jo në të gjitha Dhomat është vërejtur hapësirë e mjaftueshme për vendosjen e dëshmime që do të mundësonin trajtimin sipas rregullave dhe sistemin në atë mënyrë që qasja me to të jetë e lehtë dhe efikase në kohë. Në katër (4) Dhoma të dëshmime, hapësira e planifikuar për vendosjen dhe ruajtjen e dëshmime është e mbushur tërësisht me dëshmi. Dhomat e dëshmime në DRP-Prishtinë, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë Veriu nuk kanë hapësira të mjaftueshme për ruajtje dhe ka mbingarkesë të dëshmime. Në pamundësi për t'i sistemuar dëshmitë nëpër rafte, zyrtarët përgjegjës kanë vendosur dëshmi edhe në dysheme.

3.2.16. Dhoma e dëshmime duhet të ketë të instaluar alarm të ndërhyrjes, i cili detekton kur hapet dera pa autorizim. Sistemi i alarmit duhet testuar çdo muaj dhe duhet mbajtur shënime në lidhje me këtë. Sistemi mund të aktivizohet nga detektorët e lëvizjes dhe siguron një regjistër të mirë afatgjatë për gjitha hyrjet, me ç'rast duhet të bëhet edhe deponimi digjital i imazheve në procesor të serverit. Pesë (5) nga tetë (8) dhomat e inspektuara janë të pajisura me sistem të alarmit për të parandaluar hyrjet e paautorizuara, mirëpo vetëm në Dhomën e dëshmime në DRP-Ferizaj dhe Mitrovicë Jugu, ky alarm është funksional. Funksionaliteti i alarmit është testuar gjatë kohës së inspektimit. Dhomat e dëshmime në DRP-Prizren, Pejë dhe Mitrovicë Veriu kanë të instaluar një sistem të tillë, mirëpo ai nuk është funksional. Në DRP-Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan nuk është i instaluar sistemi i alarmit.

3.2.17. Procedura Standarde e Operimit ka paraparë që secila Dhomë e dëshmime duhet të jetë e monitoruar me sistem të kamerave të vendosura në pjesët hyrëse të Dhomave të dëshmime dhe në hapësirat e brendshme të tyre. Në të njëjtën kohë ky monitorim duhet të deponojë imazhet në

procesorin e serverit. Disa Dhoma nuk kanë përmbushë këtë kriter, pasi në disa raste nuk kanë pasur fare të vendosura kamera, kurse disa prej tyre edhe pse i kanë të instaluar, në kohën e inspektimit ato nuk kanë qenë në funksion. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Prishtinë, kamera ka pasur vetëm në parahyrje të Dhomës së dëshmime dhe në dhomën nr. 1, kurse, dhomat e tjera nuk kanë kamera. Në DRP-Mitrovicë Jugu, hapësirat e deponimit janë pjesërisht të monitoruara dhe e pambuluar me vëzhgim të kamerave është dhoma ku ruhen armët e zjarrit. Dhomat e dëshmime në DRP-Gjilan e Prizren kanë sistemin e kamerave, mirëpo nuk dihet nëse ato janë funksionale, pasi që Zyrtarët përgjegjës të tyre nuk kanë qasje në monitorimin e pamjeve përmes tyre dhe nuk janë në dijeni për funksionalitetin e tyre. Kurse, Dhomat e dëshmime në DRP-Ferizaj, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë Veriu kanë të instaluar kamerat dhe të njëjtat janë funksionale.

3.2.18. Dhoma e dëshmime duhet të jetë e pajisura me aparate për shuarjen e zjarrit, detektorët e tymit, solucion për larje urgjente të syve dhe lavamanët për mbajtjen e higjienës. Po ashtu, edhe frigoriferi është i domosdoshëm për ruajtjen e dëshmime-materieve të caktuara biologjike. Të gjitha Dhomat e dëshmime të inspektuara kanë qenë të pajisura më aparate për shuarjen e zjarrit (në Dhomën e dëshmime në DRP-Mitrovicë Veriu, aparati për shuarjen e zjarrit ka qenë me afat të skaduar). Gjashtë (6) nga tetë (8) Dhomat e dëshmime të inspektuara kanë qenë të pajisura me detektor tymi (në Mitrovicë Jugu, Prishtinë dhe Ferizaj detektor i tymit ka qenë funksional, në Prizren, Pejë dhe Gjilan ky sistem ka qenë jashtë funksioni, ndërsa në Gjakovë dhe Mitrovicë Veriu, Dhomat nuk kanë të instaluar detektorët e tymit). Të gjitha Dhomat e dëshmime janë të pajisura më frigoriferë për ruajtjen e dëshmime-materieve biologjike. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Pejë, frigoriferi është jashtë funksionit dhe dëshmitë biologjike dërgohen për ruajtje në Dhomën e dëshmime në Stacionin Policor-Pejë. Në DRP-Gjilan, frigoriferi i dhënë si donacion nga ICITAP-i nuk është në përdorim dhe gjendet në një dhomë tjetër afër Dhomës së dëshmime. Dhoma ku gjendet frigoriferi është e demoluar, muret e saj janë të dëmtuara, përfshirë dhe pjesën e tavanit, e cila ka rënë pothuajse plotësisht nga lagështia. Qëndrimi i frigoriferit në atë dhomë tregon neglizhencën e zyrtarëve përgjegjës për ruajtjen e pasurisë policore dhe mospërdorimi i tij pamundëson ruajtjen e dëshmime biologjike. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Gjilan janë parë dëshmi-materie biologjike, të cilat ruhen jashtë frigoriferit në mënyrë jo të duhur dhe për të njëjtat IPK ka mbajtur procesverbal dhe ka bërë fotografi. Në të njëjtin vend (dhomë) në Gjilan gjenden edhe raftet metalike për vendosjen e dëshmime, si donacion i ICITAP-it, të cilët nuk janë në përdorim. Dëshmitë janë vendosur në raftet druri dhe në dysheme. Raftet e drurit kanë thithur lagështi, e cila kalon edhe në prova materiale. Asnjë Dhomë e dëshmime nuk është e pajisur me lavaman për mbajtjen e higjienës.

#### ***Rekomandimi nr. 11***

*IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal, që në koordinim me Drejtorin e Departamentit për Operacione dhe Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse, të analizojnë gjendjen ekzistuese në të gjitha Dhomat e dëshmime në kuadër të drejtorive rajonale, në drejtim të sigurimit të kushteve cilësore për sistemin, akomodimin dhe ruajtjen e dëshmime (instalimin-përmirësimin e sistemeve të alarmeve, të monitorimit, të detektimit të tymit, të ventilimit, etj).*

3.2.19. Revizioni është një rishikim formal periodik verifikues për të vërtetuar korrektësinë dhe rrjedhën e punës në Dhomat e dëshmime. Një revizion i duhur është një inspektim i paanshëm i parimeve, procedurave dhe veprimeve për të përcaktuar nëse janë përcjell standardet. Revizionin



e brendshëm e bën shefi i hetuesisë (apo i autorizuari i Drejtorit Rajonal, Komandanti i Stacionit) së paku një herë në tre (3) muaj, në grupe të përzgjedhura në bazë të rastësisë të dëshmime me ndjeshmëri të lartë, siç janë: armët e zjarrit, bankënotat e falsifikuara apo sendet me vlerë dhe substanca të kontrolluara. Për të kontrolluar rrjedhën e punës dhe respektimin e standardeve në Dhomat e dëshmime, IPK ka siguruar raporte mbi revizionet e realizuara nga disa drejtori. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Ferizaj janë dëshmuar dy revizione të realizuara në vitin 2019. Sipas Raportit të tremujorit të dytë të këtij viti, Komisioni ka kryer revizion duke përzgjedhur në baza rastësore dy raste me dëshmi përcjellëse të deponuara në Dhomën e dëshmime. Revizioni nuk është kryer bazuar në udhëzimet e përcaktuara në PSO ku mjetet apo dëshmitë e zgjedhura duhej të ishin nga dosjet për armët, bankënotat, narkotikët dhe dëshmitë tjera për inspektim. Dëshmitë e inspektuara nga Komisioni kanë qenë një telefon dhe një kaçavidë, kurse në revizion nuk janë përfshirë dëshmitë tjera të përcaktuara më lartë. Parregullësitë e hasura nga inspektorët e IPK-së mbi mënyrën e ruajtjes së dëshmime (që bankënotat nuk ruhen në Dhomën e dëshmime në sefin e paraparë për ruajtjen e gjërave me vlerë) nuk janë paraqitur në raportet e revizionit dhe inspektimit të bëra nga DRP-ja. DRP-Prizren ka kryer revizione brenda Dhomës së dëshmime në periudhën e mbulimit të inspektimit, mirëpo nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se janë bërë revizione në çdo tre muaj. DRP-Prishtinë ka kryer dy revizione në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, duke verifikuar përmbushjen e standardeve për dëshmitë e përzgjedhura nga dosjet e armëve, bankënotave dhe dëshmime të tjera brenda zonës së deponimit. Nuk është bërë revizion së paku në çdo tre muaj për vitet 2017 dhe 2018. Në Dhomën e dëshmime në DRP-Pejë ka patur revizione në periudha të ndryshme gjatë viteve 2017-2019 (dy në vitin 2019, tre në vitin 2018 dhe dy në vitin 2017). Në Dhomën e dëshmime në DRP-Mitrovicë Veriu janë kryer dy revizione në vitin 2018, kurse në DRP-Mitrovicë Jugu, Gjilan dhe Gjakovë nuk janë prezentuar raporte të revizionit të realizuara në periudhën e mbulimit të inspektimit. Mungesa e revizioneve vjen si rezultat i neglizhencës dhe nuk ngritë përgjegjësinë në trajtimin e duhur të dëshmime.

3.2.20. Inventarizimi është regjistrim dhe verifikim i pranisë së sendeve/dëshmime të mbajtura në Dhomën e dëshmime në krahasim me regjistrat. Inventarizimi duhet të kryhet së paku një herë në vit, çdo herë kur ka ndërrim të personelit apo me kërkesë të Drejtorit Rajonal. Është siguruar një numër i raporteve të inventarizimit në Dhomat e dëshmime për të verifikuar nëse kanë arritur të përmbushin detyrat në regjistrimin, evidentimin dhe verifikimin e sendeve në krahasim me regjistrat. DRP-të që kanë kryer inventarizim në Dhomat e dëshmime janë DRP-Pejë (për vitet 2017 e 2019) dhe DRP-Mitrovicë Jugu për vitin 2019. Nga raportet shihet se komisionet nuk kanë ndjekur mënyrën e përcaktuar të veprimit për të regjistruar dhe verifikuar secilën dëshmi të mbajtur brenda secilës zonë të deponimit në krahasim me regjistrat. Nga raportet e prezentuara, shihet se gjatë inventarizimeve nuk janë verifikuar të gjitha dëshmitë e deponuara. DRP-Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Veriu, Gjakovë dhe Prishtinë nuk kanë realizuar inventarizime për periudhat, në të cilat është shtrirë inspektimi. Mungesa e inventarizimit rritë pasigurinë mbi ekzistencën e të gjitha dëshmime në hapësirat e deponimit dhe dobësitë e evidentuara janë rezultat i neglizhencës.

3.2.21. Me qëllim të rishikimit të procesit të punës, sigurisë dhe kushteve, në të cilat punojnë zyrtarët policor, nivelit të pastërtisë, si dhe përfilljen e procedurave duke përfshirë edhe shikimin e regjistrave, Shefi i Sektorit të Hetimeve në Drejtorinë Rajonale duhet të kryejë sa më shpesh inspektime të paparalajmëruara në Dhomën e dëshmime. IPK-ja rëndësi të posaçme u ka kushtuar edhe inspektimeve të kryera brenda Dhomave të dëshmime dhe gjetjeve. Në Dhomat e dëshmime

në DRP-Prishtinë janë kryer inspektime në vitin 2017 dhe 2018, në DRP-Gjakovë dhe Mitrovicë Veriu në vitin 2019, kurse në DRP-Gjilan në vitin 2017 është bërë një inspektim i tillë. Mirëpo, është gjetur se jo në kuadër të të gjitha DRP-ve janë kryer inspektime në periudhën 2017, 2018 dhe 2019, si p.sh. në DRP-Mitrovicë Jugu, Ferizaj, Prizren dhe Pejë nuk janë prezentuar raporte të inspektimit. Inspektimi ngritë përgjegjësinë, ngase aktivizon zyrtarët përgjegjës që të jenë më të përkushtuar. Mungesa e inspektimeve është rezultat i neglizhencës së drejtuesve rajonal për të ushtruar kontrollin e nevojshëm mbi Dhomat e dëshmime.

***Rekomandimi nr. 12***

*IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonalë që të ushtrorjnë kontrole të brendshme periodike përmes revizionit, inventarizimit dhe inspektimit, me qëllim të shtimit të masave të nevojshme për të trajtuar dëshmitë në mënyrën e duhur, siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit në fuqi.*

## 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 30.12.2019, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të përmbushin obligimin e dalë nga neni 70, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sipas të cilit, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer vepër penale, brenda 24 orëve duhet t'i dërgojë raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.	II	Është dërguar raporti tek Drejtoritë Rajonale të Policisë më c' rast është kërkuar që të respektohet Kodi i Procedurës Penale, neni 70.paragrafi 5, njëkohësisht do të aranzhojmë takim me Këshillin Prokurorial të Kosove me qëllim të gjetjes së modaliteteve dhe harmonizimit të praktikave në teren dhe KPP.	Janar-shkurt 2020
2.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e ngarkuar me raste penale, që të eliminohen dobësitë e identifikuar gjatë inspektimit që lidhen me mungesën e planeve të hetimit brenda rasteve të inicuar, si dhe kontrollin e pamjaftueshëm nga mbikëqyrësit gjatë procedimit të lëndëve tek organi i akuzës.	I	Do të bëhet shkresa tek Drejtorët rajonalë, që të shtojnë kontrollin bashkërisht me Shefat e Sektorit të hetimeve rajonale, në mënyrë që asnjë lëndë mos të dërgohet në Prokurori pa kontrollin dhe nënshkrimin e mbikëqyrësit përkatës.	Janar 2020
3.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve, që me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo të dyshuarve, t'u lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe në fund të marrjes në pyetje, procesverbalet (deklaratat) të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.	I	Do të bëhet shkresa tek Drejtorët rajonal, që të shtojnë kontrollin bashkërisht me Shefat e Sektorit të hetimeve rajonale .	Janar-mars 2020
4.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve Rajonalë të Hetimeve që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit në mënyrë që gjatë kryerjes së veprimeve hetimore të aplikohen formularët unikë që janë të	I	Do të bëhet shkresa tek Drejtorët rajonalë, njëkohësisht ju është dërguar formulari unik dhe është kërkuar që të përdorën formular unik i cili është i	Janar 2020



	<i>harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të krijimit të dosjeve të standardizuara hetimore.</i>		<i>vendosur edhe në formë elektronike në intranet.</i>	
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit përgjegjës të Dhomës së dëshmime në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore - Ferizaj që të gjitha dëshmitë dhe sendet e konfiskuara të ruhen brenda hapësirave të Dhomës së dëshmisë, kurse bankënotat dhe gjërat e çmuara të deponohen në sef apo arkë metali brenda zonës së deponimit të sendeve dhe dëshmime.</i>	<i>I</i>	<i>Kemi dërguar raportin inspektues të gjithë drejtorëve rajonal dhe njëkohësisht kemi kërkuar që ky rekomandim të merret shumë seriozisht dhe mos të përsëritën lëshime të tilla.</i>	<i>Janar 2020</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmime në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore, që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të mbyllura dhe të paketuara në paketime adekuata, dhe të njëjtat të ruhen në vende të posaçme varësisht nga specifikat, me qëllim të ruajtjes nga dëmtimet e mundshme.</i>	<i>I</i>	<i>Kemi dërguar raportin inspektues të gjithë drejtorëve rajonal dhe njëkohësisht kemi kërkuar që ky rekomandim të merret shumë seriozisht dhe mos të përsëritën lëshime të tilla.</i>	<i>Janar 2020</i>
7.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit Rajonal të Prishtinës, që të ndërmarr veprimet e nevojshme për largimin e materialeve të rrezikshme nga hapësirat e Dhomës së dëshmime dhe në të ardhmen, deponimi i llojeve të tilla të bëhet në përputhje me Procedurën Standarde të Operimit.</i>	<i>I</i>	<i>Kam biseduar me drejtorin rajonal, njëkohësisht kam pranuar shkresë, njoftim nga ai me informacion se është në pritje të kompanisë përkatëse e cila kompani do të dërgoj për ekzaminim laboratorik jashtë vendi.</i>	<i>Janar 2020</i>
8.	<i>IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmime në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore, tek të cilat janë evidentuar rastet e hapjes së dëshmime, që në asnjë rast të mos hapen dëshmitë pa u respektuar plotësisht Procedura Standarde e Operimit për Dhomat e dëshmime, që parasheh procedurën e evidentimit special për rastet kur hapen kutitë/paketimet.</i>	<i>I</i>	<i>Drejtorit Rajonale përmes raportit janë informuar që lidhur me rekomandimet rreth qasjes në dëshmitë e rasteve, të respektohen PSO, për operimin e dhomave të dëshmime.</i>	<i>Janar 2020</i>
9.	<i>IPK-ja u rekomandon Zyrtarëve përgjegjës të Dhomave të dëshmime që me rastin e regjistrimit të sendeve/dëshmime të plotësojnë të dhënat e tyre në mënyrë ekuivalente në Regjistër dhe në në databazë</i>	<i>I</i>	<i>Drejtoritë Rajonale përmes raportit janë informuar që lidhur me rekomandimet rreth regjistrimit të dëshmime të rasteve, të bëhet harmonizimi i të dhënave si në regjistrin</i>	<i>Janar-shkurt 2020</i>

	<i>kompjuterike, duke përshkruar çdo dëshmi me specifikat dhe shenjat klasifikuese.</i>		<i>fizik ashtu edhe ne formën /regjistrin elektronik.</i>	
10.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit Rajonal të Gjilanit që në koordinim me Drejtorinë për Menaxhimin e Objekteve, që në afatin sa më të shkurtër kohor, të dislokojë dëshmitë në një hapësirë tjetër të përshtatshme, e cila do t'i plotësonte kushtet e vendosjes dhe ruajtjes së sendeve, pasurisë dhe provave të konfiskuara, me qëllim të shmangies së tyre nga dëmtimi dhe humbja e vlerës.</i>	II	<i>Rekomandimi është përcjellë ne Drejtoritë Rajonale përkatëse, njëkohësisht kemi kërkuar që kjo Drejtori ne bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të objekteve të bëjnë një zgjedhje sa me të shpejtët, me qëllim të ruajtjes së vlerës së dëshmive .</i>	<i>Janar-prill 2020</i>
11.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal, që në koordinim me Drejtorin e Departamentit për Operacione dhe Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse, të analizojnë gjendjen ekzistuese në të gjitha Dhomat e dëshmive në kuadër të drejtorive rajonale, në drejtim të sigurimit të kushteve cilësore për sistemimin, akomodimin dhe ruajtjen e dëshmive (instalimin- përmirësimin e sistemeve të alarmeve, të monitorimit, të detektimit të tymit, të ventilimit, etj).</i>	II	<i>Është dërguar shkresa tek Drejtorit Rajonale të Policisë, me c 'rast është kërkuar që të behet një vlerësim i gjendjes së dhomave të dëshmive, dhe aty ku konstatohet se gjendja nuk është ne rregull te veprohet ne koordinim me Drejtorin e Menaxhimit të Objekteve dhe te sanohen defektet eventuale.</i>	<i>Janar-qershor 2020</i>
12.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonalë që të ushtrojnë kontrole të brendshme periodike përmes revizionit, inventarizimit dhe inspektimit, me qëllim të shtimit të masave të nevojshme për të trajtuar dëshmitë në mënyrën e duhur, siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit në fuqi.</i>	I	<i>Është dërguar raporti tek Drejtorit Rajonale të Policisë , dhe është kërkuar që inspektimet, revizionet dhe inventarizimi të behën bazuar ne PSO, dhe rekomandimet e IPK-së.</i>	<i>Janar 2020</i>

<b>Shtojca 1: Të dhëna mbi përmbushjen e rekomandimeve nga inspektimet e mëparshme</b>				
<b>Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2013)</b>				
<b>Inspektimi: Dhomat e dëshmime në Policinë e Kosovës nr. 5/2013</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Rekomandimi i dhënë</b>	<b>Komentet e strukturës policore (në origjinal)</b>	<b>Afatet për zbatim</b>	<b>Niveli i zbatimit</b>
1.	<i>IPK-ja i rekomandon drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetës që të intensifikojë bashkëpunimin me drejtorin e Departamentit për Hetime si dhe drejtorët rajonalë në mënyrë që Departamenti për Shërbime Mbështetëse të pajisë dhomat e dëshmime me rafte lëvizëse, kontenier, kuti standarde, frigorifer, shuarës të zjarrit dhe pajisje tjera adekuate për secilën dëshmi.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon drejtorët rajonal policor (DRP-Ferizaj, DRP-Gjilan) që të ndërmarrin masat adekuate për të eliminuar lagështinë në dhomat e dëshmime që ky problem është evident.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
3.	<i>IPK-ja rekomandon drejtorëve rajonal policor të DRP-Mitrovicë dhe DRP-Gjilan që në dhomat e dëshmime ku dyert kanë kapëset nga ana e jashtme të vendosin mjete shitesë për sigurimin e tyre.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
4.	<i>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të angazhuar në dhomat e dëshmime që në Regjistrin e dëshmime dhe bazën elektronik të të dhënave, si dhe në kabina, rafte, sirtarë dhe kuti metalike të prezantojnë edhe informacionin mbi vend ndodhjen e dëshmime (lokacionin e saktë të deponimit).</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
5.	<i>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të dhomës së dëshmime që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rastit të sigurohen se dëshmitë janë të paketuara në paketime standarde, të cilat ruajnë dëshmitë nga dëmtimet e mundshme apo humbjet</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të dhomës së dëshmime që me rastin e regjistrimit të sendeve/dëshmime të bëjë plotësimin e të dhënave në mënyrë ekuivalente edhe në data bazën elektronike.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Përgjithësisht</i>

7.	<i>IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë që të merr masa për të siguruar qese letre me shënime në gjuhët zyrtare si dhe të obligojë zyrtarët e dhomës së dëshmive për të plotësuar me shënime pjesën e dytë të qeses së letrës për tu siguruar se ka shënime sa i përket zinxhirit të ruajtje (from- to- date).</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Nuk është vlerësuar</i>
8.	<i>IPK-ja rekomandon Drejtorinë për Planifikim Strategjike dhe Çështje Ligjore të angazhohet në përpilimin e një dokumenti të ri që do të rregullonte në përpikëri punën në Dhomat e dëshmive.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
9.	<i>IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë policor që të kenë kujdes sa i përket mekanizmit të kontrollit të brendshëm dhe të angazhohet për të mbikëqyrur dhe të kërkojë llogaridhënie se a i përket raportimeve lidhur me inventarizimin, revizionimin dhe inspektimin e dhomave të dëshmive</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
10.	<i>IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë të angazhoj Divizionin e Trajnimeve që të organizojnë trajnime adekuate për zyrtarët policor të dhomave të dëshmive</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Nuk është vlerësuar</i>
11.	<i>IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë të angazhohet për të aftësuar edhe disa persona tjerë alternativ për të pasur njohuri sa i përket punëve në dhomën e dëshmive.</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Nuk është vlerësuar</i>
12.	<i>IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë të angazhohet që të gjitha dhomat e dëshmive të aplikojnë data bazën elektronike e cila është donacion i ICITAP-it, në mënyrë që të ketë regjistrim unik (standardizuar).</i>			<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>